

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
	KOMUNA VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRN
QNe / Br	796/12
Nr. Isp./ Dok. nr.	
Datum / Datum	05.07.2017
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural nr.41/2017, dt. 04.07.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR KORRJE-SHIRJE

1. Me këtë vendim formohet komisioni për përcjellje të fushatës së korrje-shirjeve në këtë përbërje:
 - 1.1 Arta Haxhaj, kryesuese e shtabit (Drejtoreshë për EBPZHR)
 - 1.2 Behram Rrahmani, anëtar (Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim)
 - 1.3 Mexhit Perçuku, anëtar (DEBPZHR.)
 - 1.4 Nexhmi Cakaj, anëtar (DEBPZHR.)
 - 1.5 Xhavit Shala, anëtar (agronom)
2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi do të përcjell përkatesisht monitoroj mbarëvajtjen e fushatës së korrje shirjeve në territorin e komunës së Vushtrrisë si dhe të hartoj raport me shkrim për organet kompetente lidhur me përfundimin e fushatës si dhe rendimentet e arritura nga korrje shirjet.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtoreshës për ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural, anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - OPËTKA VUÇITRVA
03/Nr. /D/ - <u>821/17</u>
Nr. /D/ / D. M. _____
Ditë/ Datum: <u>12.07.2017</u>
VUÇITRRI - VUÇITRVA



Republika e Kosovës

Komuna-Vushtrri

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 67 "P" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës me datë _____ merr këtë

**VENDIM
PËR FORMIM TË KOMISIONIT**

1. Formohet komisioni për hartim të Draft-Rregullores për Tatim në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018 në këtë përbërje:
 - 1.1 Gjylsime Feka-Ferati-Kryesuese
 - 1.2 Mexhit Përçuku - anëtar
 - 1.3 Besim Muzaqi - anëtar
2. Komisioni në fjalë duhet të hartoj draftin e Rregullores për Tatim në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017 dhe të njëjtën ta procedoj në Komitetin për Politikë e Financa për shqyrtim.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit
4. Vendimi ia dërgohet Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë





849/17
-01-
21.07.2017

2841
1
21.07.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture Forestry and Rural Development

Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuciterna
Municipality of Vushtria

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR FUTJEN E TË DHËNAVE NË SISTEMIN E
RREGULLIMIT TË TOKËS DHE RI RREGULLIMIN E TABELËS NR.15 ZK
BAJSKE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

E lidhur ndërmjet:

1. Ministria e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Adresa: "Nëna Terezë" nr.44 Prishtinë (në tekstin e mëtutjeshëm MBPZHR) në njëren anë,
2. Komuna e Vushtrrisë, Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina" Nr.173 Vushtrri, (në tekstin e mëtejme Komuna), në anën tjeter.

Neni 1
Qellimi

Kjo marrëveshje mirëkuptimi ka për qëllimi Ndryshimin dhe Plotësimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Financimin e Projektit për Futjen e të Dhënavës në Sistemin e Rregullimit të Tokës dhe Ri rregullimin e Tabelës Nr.15 ZK Bajkske në Komunën e Vushtrrisë të dit. 30.05.2017.

Neni 2

Neni 3 i marrëveshjes baze fjalë "e subvencioneve dhe transfereve" zëvendësohet me fjalë "e mallrave dhe shërbimeve".

Neni 3

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje identike, nga një (1) kopje për se cilën pale kontraktuese.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit 21.07.2017

PËR: MBPZHR
 Sekretari i Përgjithshëm
 Z. Kapllan HAJDRI

/Nënshkrimi/

PËR: Komunën e Vushtrrisë
 Kryetar
 Z. Balazin MHLAKU

/Nënshkrimi/



KOMUNË SË VUSHTRRI, REPUBLIKA KOSOVË	
MINISTRIA PËR PËRSHTRIM - OPATINA VUÇITRE	
852/17	
Ministratë	-03-
21.07.2017	
VUÇITRE - VUÇITRE	



Komuna Vushtrri

Këshilli i Bashkësisë Islame

Në bazë të autorizimeve ligjore, synimeve të përbashkëta për punë të mirë në dobi të komunitetit dhe përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Bajram Mulaku dhe Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame-Vushtrri, z. Shemsi Rrahimi, lidhin këtë;

**Memorandum mirëkuptimi
mes
Komunës së Vushtrrisë,
dhe
Këshillit të Bashkësisë Islame – Vushtrri
për
dhurimin e objektit shëndetësor si aset i komunës së Vushtrrisë**

- për të cilën palët pajtohen si në vijim;

Neni 1.

Qëllimi i memorandumit

1.1 Qëllimi i këtij memorandumi është pëlqimi i palëve të shënuara më lartë (komunës së Vushtrrisë dhe KBI-Vushtrri) për dhurimin – donacion të objektit të ndërtuar nga donacionet e KBI-së, për nevojat e Komunës së Vushtrrisë, përkatësisht për destinim të caktuar – Qendër e Mjekësisë Familjare.

Neni 2.

Vlera e projektit

- 2.1. Vlera e projektit të ndërtimit të këtij objekti shëndetësor në Vushtrri është rrëth 100.000 € (njëqind mijë euro).
- 2.2. Vlera e financimit nga donacioni i siguruar nga KBI-Vushtrri, është 100.000 (njëqind mijë euro).

Neni 3.

Obligimet e palëve

3.1. Obligimet e Komunës;

- 3.1.1 Komuna merr përsipër inventarizimin e objektit dhe furnizimin me pajisje të nevojshme mjekësore.
- 3.1.2 Komuna do ti zhvillojë procedurat për këmbimin e pronës së Këshillit të Bashkësisë Islame – Vushtrri në të cilën është ndërtuar objekti i qendrës së mjekësisë familjare me pronë komunale në pajtim me vendimin e Kuvendit të Komunës, numër 183/17, të datës 29 qershor 2017.

3.2. Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame- Vushtrri

- 3.2.1. KBI- Vushtrri do ti dhuroi komunës së Vushtrrisë objektin shëndetësor të tipit, qendër e mjekësisë familjare – QMF, si aset të saj.
- 3.2.2. KBI-Vushtrri, do ti dhurojë komunës së Vushtrrisë me këmbim, pronën e saj me numër të parcelës 263, në sipërfaqe prej 10 ari, për objektin e ndërtuar, në bazë të vlerësimit të cilin do ta bëj organi kompetent sipas legjisacionit në fuqi.
- 3.2.3. Në ditën e plotfuqishmërisë së vendimit të kuvendit të komunës numër 183/17, të datës 29 qershor 2017 për këmbim të pronave të paluajtshme, do të bëhet regjistrimi në librat kadastral, konform këtij vendimit dhe kësaj marrëveshje.

Neni 4.

Mospajtimet dhe paqartësitë

Palët janë pajtuar në mes vete që mos marrëveshjet eventuale apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 5.

Kohëzgjatja

Ky memorandum do të jetë i plotfuqishëm gjer në përbushjen e obligimeve nga palët.

Neni 6.

Hyrja në fuqi

6.1. Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në katër ekzemplar dhe do të ju dorëzohet palëve, donatorit dhe DSHPS-së.

6.2. Ky memorandum do të hyj në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Bajram Mulaku

Kryetari i Komunës



Shemsi Rahimi

Kryetari KBI – Vushtrri

21.10.71 2017
Vushtrri



Komuna e Vushtrrisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - QËMICA VUÇITRNI	
02704/08	861/17
Nr. 139 / 10. vj	- 5 -
Ditet / Datum: 25. 07. 2017	
VUSHTRRI - VUÇITRN	

NDIMMO
EDHETI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur me datën 25 korrik 2017, në Vushtrri në mes të palëve:

Komunës së Vushtrrisë

dhe

Organizatës Jo Qeveritare “NDIMMO EDHE TI”

më tutje e referuar si “OJQ”

L. LL

Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga z. Bajram Mulaku, kryetar i Komunës së Vushtrrisë dhe Organizatës Jo Qeveritare "Ndihamo edhe Ti", e përfaqësuar nga z. Liridon Llapashtica, drejtor ekzekutiv.

Konteksti

Duke synuar arrijen e qëllimeve dhe objektivave që kanë të bëjnë me mbledhjen e fondeve brenda dhe jashtë vendit dedikuar familjeve në nevojë si dhe ofrimin e një programi i cili do ta thyente ciklin e varfërisë, duke u bazuar në kapacitetet e strukturës menaxheriale, janë pajtuar që të lidhin këtë marrëveshje, si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është angazhimi i palëve në një marrëdhëniet bashkëpunuese, nga e cila do të shkëmbohen informacione dhe do të bashkërendohen veprimtaritë me synimin e përbashkët për të ndihmuar dhe parandaluar varfërinë, duke krijuar programe me mundësi të mbështetjes së familjeve të varfra për strehim, furnizim me materiale ushqimore apo veshimbathje, zhvillimin e programeve të aftësimit profesional për krijimin e mundësive të punësimit të personave në gjendje të rëndë sociale.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

Palët kanë përcaktuar format e mëposhtme të bashkëpunimit, por që nuk kufizohen vetëm në këtë:

1. Shkëmbimin e informacioneve mbi kategoritë sociale që menaxhohen nga Komuna e Vushtrrisë, sipas legjislacionit në fuqi dhe kapaciteteve të OJQ;
2. Ofrimin e ndihmës për personat dhe familjeve që janë në nevojë materiale dhe sociale, në pajtim me mundësitë buxhetore;
3. Ofrimin e programeve mbështetëse, për personat dhe familjet me nevoja sociale, sipas mundësive që do të ketë OJQ;

4. Avokimin dhe lobimin për mbrojtjen e interesave për personat dhe familjet të cilët janë në gjendje të rëndë materiale dhe sociale.

Neni 3

Baza e bashkëpunimit

Baza e bashkëpunimit për realizimin dhe implementimin e kësaj marrëveshje në mes të palëve nënshkruese është legjislacioni i aplikuar dhe në fuqi i Republikës së Kosovës nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes:

Neni 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve

Përgjegjësit e Komunës së Vushtrrisë;

1. Komuna e Vushtrrisë do të ofroj përkrahje OJQ-së në zhvillimin e programeve dhe projekteve në fushën e mbrojtjes sociale dhe punësimit për kategoritë sociale;
2. Komuna e Vushtrrisë do të ofroj përkrahje në koordinimin e procesit të bashkëpunimit në mes të Komunës dhe OJQ-së;
3. Komuna e Vushtrrisë do të caktojë një person përgjegjës për koordinim të procesit të bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ-së për identifikimin dhe sigurimin e të dhënavëve pë Familjet apo personat që kanë nevojë për mbështetje;
4. Komuna e Vushtrrisë do të ofroj hapësira dhe kushtet të përshtatshme për zhvillimin e programeve të trajnimeve me qëllim punësimi të kategorive sociale, të identikuara nga OJQ;

Përgjegjësit e OJQ-së "Ndihmo edhe Ti"

1. OJQ në bashkëpunim me komunën, do të identifikon personat dhe familjet që kanë nevojë për stërim, ushqim dhe aftësim profesional;
2. OJQ do të përkrah finansiarisht, personat dhe familjet që kanë nevojë për stërim dhe ushqim;



L. L. S.

3. OJQ do të zbaton programe dhe projekte të cilat ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së familjeve të varfra apo programe e të ashtuquajturit "Cikli i varfërisë".

Neni 5

Komuna e Vushtrrisë në rast të mundësive buxhetore në kategorinë e subvencioneve për bashkëfinancim me donator, bashkë finançon me OQJ-në "Ndihmo edhe Ti" me mjete financiare për ndërtimin e shtëpive për banim për familjet e pa strehë.

Neni 6

Modifikimi, shfuqizimi apo shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit mund të modifikohet apo shfuqizohet në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji apo akti nënligjor, fushëveprimi i të cilit mbulon ndonjë nga pikat e kësaj marrëveshje – dispozitat e së cilës janë në kundërshtim me ato të aktit juridik shtetëror.
2. Modifikimi eventual i kësaj marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e institucioneve / organeve zbatuese të kësaj marrëveshjeje.
3. Secila nga palët nënshkruese mund të tërhiqet nga marrëveshja brenda tridhjetë (30) ditëve pas njoftimit të palës tjetër me shkrim, i cili në përbajtje është i arsyetuar sipas bazës ligjore përkatëse.
4. Data e paralajmërimit me njoftim do të konsiderohet data e pranimit të dokumentit.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "J. H. S." followed by a surname, is located in the bottom right corner of the page. A small number '4' is positioned above the end of the signature.

Neni 7

Kohëzgjatja, përfundimi dhe ndryshime

1. Bashkëpunimi i propozuar në këtë marrëveshje të Mirëkuptimit zgjatë deri në fund të vitit 2017 nga data e nënshkrimit të saj, me mundësi vazhdimi.
2. Palët mund të negocijnë zgjerimin e fushëveprimit së kësaj marrëveshje. Në çdo rast ndryshimet do të shkëmbhen në formë zyrtare me shkrim.

Neni 8

Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, nga një (1) për secilën palë nënshkruese.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit hyn në fuqi prej momentit të nënshkrimit të saj.

PALËT NËNSHKRUÉSE

Komuna e Vushtrrisë

Bajram Mulaku,
Kryetar i komunës së Vushtrrisë

OJQ "Ndihmo edhe Ti"

Liridon Llapshani
OJQ " Ndihmo edhe Ti"

Vushtrri

25 / 07 / 2017



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUŠTRRI	
03. Nrs / Nr.	883 / 17
Nr. i reg./Reg. nr.	- 4 -
Datum / Datum	31. 07. 2017
VUŠTRRI - VUŠTRRI	

Memorandum i Mirëkuptimit

midis

Komunës së Vushtrrisë

dhe

Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)

Vushtrri, 31.07.2017

Neni 1
Përkufizimet

Përkufizimet që do të përdoren në vijim për nevojat e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë si vijon:

- a. "GIZ SMS" do të thotë Programi për Shërbime të Qëndrueshme Komunale i Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar;
- b. „GIZ“ do të thotë Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe mund të përfshijë edhe projekte të tjera të GIZ-së përvèç ShQK-së;
- c. "MoU" do të thotë Memorandum i Mirëkuptimit.

Neni 2
Palët

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar dhe lidhur midis Komunës së Vushtrrisë, Rr. Adem Jashari no. 1, 42000, Vushtrri, dhe GIZ-së, Rr. Anton Çeta Nr. 1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Neni 3
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që të sigurohet bashkëpunimi i dakorduar dhe i ngushtë midis palëve nënshkruese.

Neni 4
Fushat e bashkëpunimit

Fushat e bashkëpunimit janë:

- a. Planifikimi dhe pilot projektet e menaxhimit të mbeturinave të ngurta, që përfshijnë:
 - Pilot projektet e ndarjes së mbeturinave në burim në shkollat dhe institucionet e përgjedhura;
 - Pilot projektet e ndarjes së mbeturinave në burim në zonën e përgjedhur të komunës;
 - Përcaktimi i tarifës përfshirë kalkulimin e kostove, profilizimi i klientëve dhe mekanizmat për grumbullimin e tarifës;
 - Plani operativ i grumbullimit të mbeturinave;
 - Pilotimi i trajtimit të mbetjeve organike;
- b. Reforma institucionale dhe administrative, që përfshijnë:
 - Rishikimi i modelit të operimit në menaxhimin e mbeturinave dhe implementimi;

Ndryshimet dhe amendamentet në këto fusha që do të ndikonin në bashkëpunim dhe që do të rekomandohen vetëm pas konsultimit (eve) midis palëve.

Neni 5
Përgjegjësitë

Komuna e Vushtrrisë është përgjegjëse për:

- sigurimin e personelit dhe objekteve për t'i realizuar aktivitetet në të gjitha fushat e bashkëpunimit;
- bashkërendimin e grupit punues të përbërë nga aktorë të ndryshëm;
- bashkëdrejtimin e aktiviteteve të projektit;

GIZ-ja është përgjegjëse për:

- ofrimin e shërbimeve këshillëdhënëse dhe ekspertizës teknike të drejtpërdrejtë nëpermjet projektit apo përmes konsulentëve vendorë dhe ndërkombëtarë s;
- zhvillimin dhe ndihmën në ndërtimin e kapaciteteve;
- kontraktimin e OJQ-ve për aktivitete të caktuara;

Neni 6
Detyrimet financiare

1. Shërbimet këshillëdhënëse:

Shpenzimet për këshillëdhënë që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me aktivitetet do t'i mbulojë GIZ-ja. GIZ-ja i rezervon të drejtat e saj për t'i mbuluar vetëm shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme që ndërlidhen me aktivitetet. Pagat e personelit të komunës që ndihmon në bashkëpunim mbesin përgjegjësi e komunës.

2. Pilot projekti i ndarjes së mbeturinave në burim në shkolla dhe institucione

Shpenzimet për investime kapitale që ndërlidhen me këtë pilot projekt do t'i mbulojë GIZ-ja deri në një kufi të caktuar. Prokurimi i investimeve kapitale do të realizohet vetëm nëse bazohet në planifikim racional dhe studime të fizibilitetit.

3. Zbatimi i pilot projektit të ndarjes së mbeturinave në burim

Shpenzimet kapitale për investim që ndërlidhen me këtë pilot projekt do të bashkëfinancohen midis GIZ-së dhe komunës. Shumat e bashkëfinancimit do të negociohen ndaras.

Shpenzimet për zbatimin e vazhdueshëm të pilot projekteve të lartpërmendura dhe realizimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta do t'i mbulojë komuna.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

GIZ SMS-ja merr buxhet për vetëm një vit fiskal; të gjitha zotimet që merren me këtë Memorandum të Mirëkuptimit i nënshtronen disponueshmërisë së burimeve buxhetore të mjaftueshme në dispozicion për vitin 2017 e më tej. GIZ SMS-ja do ta informojë komunën posa të jetë e mundur që të parashikohen shkurtimet buxhetore.

Mbulimi i shpenzimeve mund të zbatohet vetëm në pajtim me procedurat e brendshme të prokurimit të GIZ-së.

Neni 7
Zbatimi i MiM-së



Komuna dhe GIZ-ja merren vesh për një komision drejtues për bashkëpunim, i cili mund të përfshijë edhe palë të treta.

Komuna dhe GIZ-ja do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për tu siguruar që anëtarët e personelit që angazhohen në kuadër të këtij bashkëpunimi të jenë të standardeve më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit.

**Neni 8
Ndryshimi**

Të gjitha ndryshimet dhe amendamentet e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit rekomandohen vetëm pas konsultimit (eve) midis palëve.

Pas konsultimit (eve), ky Memorandum i Mirëkuptimit mund të ndryshohet me anekse, me marrëveshje të përbashkët midis të dyja palëve, të shprehura dhe të nënshkruara në 2 ekzemplarë origjinalë.

**Neni 9
Komunikimi dhe njoftimi**

Çdo koment në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit shkruhet në gjuhën angleze dhe shqipe, ndërsa i transmetohet palës tjetër për të arritur marrëveshje.

**Neni 10
Palët nënshkruese**

Palët merren vesh që ta nënshkruajnë këtë Memorandum të Mirëkuptimit në 2 ekzemplarë origjinalë më datën e shkruar më poshtë.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi më datën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri më datën 31. 3.2019.

Çdo vazhdim i bashkëpunimit është i mundur dhe për të kërkohet aneks shtesë. Palët mund ta anulojnë këtë Memorandum i Mirëkuptimit në çdo kohë me anë një njoftimi me shkrim para 6 javëve.



Z. Bajram Mulaku
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Vendi/Data

J. U.
Z. Kai Hofmann
Menaxher i Programit GIZ SMS

31.07.2017

Vendi/Data